

Date 18.11.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ruajtja dhe Siguria Fizike në roje private dhe shoqërimi i vlerave monetare për UKT sh.a”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): sherbime roje/ sherbime me roje

VLERA E FONDIT LIMIT: 216.570.000,02 (gjashtembedhjete milion e peseqind e shtatedhjete mije presje zero dy lekë pa TVSH.

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte **2,241,693.40** (dy milion e dyqind e dyzet e nje mije gjashteqind e nenedhjete e tre presje dyzet)euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 18.11.2025 është 96.61.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;perkatesisht në vleren 4.331.400 ,01(kater milion e treqind e tridhjete e nje mije e katerqind presje zero nje).*

Shuma e kerkuar e sigurimit te ofertes ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 44.833,86 (dyzet e kater mije e teteqind e tridhjete e tre mije e tetedhjete e gjashte) euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 18.11.2025 është 96.61 euro.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private në kategorinë ”1.3.A” si dhe në kategorinë ”1.3.B” për shoqërimin e vlerave monetare si dhe të sendeve të çmuara lëshuar nga organi kompetent, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë ne sistemin e prokurimit publik Licencë të drejtuesit teknik për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private në kategorinë ”1.3.A” me kohe te plote si dhe në kategorinë ”1.3.B” me kohe te plote për shoqërimin e vlerave monetare si dhe të sendeve të çmuara lëshuar nga organi kompetent, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e punonjesve të shërbimit për jo më pak se 58 punonjës për nënkategorinë 1.3.A, konform Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, shoqëruar me listen emerore të punonjesve të shërbimit të punësuar në DVP, Tiranë (te vlefshme brenda 4 viteve) të nënshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori. Punonjesit e pasqyruar në listen emerore të nënshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori duhet të figurojnë në listepagesat e sigurimeve shoqërore minimumi 3 muajt fundit. Në rast bashkimi të operatorve ekonomik , kjo liste duhet të paraqitet në perputhje me perqindjen e marr persiper në kontratën e bashkëpunimit.

Shënim: Për pikën 3 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë vendosur në mbështetje të ligjit nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Per rregullat e prokurimit publik”, Neni 77, pika 4 si dhe në mbështetje të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41 pika 4. Në bazë të udhëzimit të brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, përcaktohet se numri minimal i punonjësve të shërbimit për një turn duhet të jetë me koeficientin 1.66, pra për një shërbim 24 orësh (3 turne) është 4.98 roje për vendroje. Në kërkesat ruajtje sigurie për 11 vendshërbime 24 orësh të cilat në total shkojnë 54.78 roje.

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kushteve të përgjithshme të kualifikimit.

1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse

të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2025)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kështëve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të

Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që

do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit të lëshuar nga AKEP konform ligjit Nr. 9918 datë 19/05/2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" me zone mbulimi Qarkun i Tiranës.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, Neni 41 pika 4 gërma a, si dhe ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" neni 77.

Gjithashtu përcaktimi i këtij kriteri është bazuar në llojin e shërbimit, policitë private kanë detyrimin ligjor për të qenë të licencuar nga AKEP për të pasur një sistem radiokomunikimi të pavarur, për të garantuar një komunikim me një nivel të lartë sigurie, për shkak të informacionit sensitiv që mund të transmetohet mes tyre.

2.3.3 Operatorët ekonomik duhet të disponojnë qendër kontrolli në Qarkun Tiranë.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin në sistemin elektronik Akt Miratim të lëshuar nga DVP Tirane sipas ligjit ne fuqi.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, Neni 41 , si dhe ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" neni 77.

Gjithashtu bazuar në ligjin 75/2014, çdo shoqëri private e sigurisë fizike ka detyrimin ligjor të jetë e pajisur me një qendër kontrolli, për të bërë kordinimin e çdo objekti në ruajtje.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve publike Vertetim lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tirane jo më parë se 6 muajt e fundit, përmes të cilit të provohet që operatori ekonomik disponon:

- a) Punonjes shërbimi të kategorisë 1.3.A. jo më pak se 58 punonjes shërbimi.
- b) Përgjegjës shërbimi 3 punonjes.
- c) Operatori në qendër kontrollit 5 punonjes.
- d) Numri i armëve të gjata, kategoria (B4) jo më pak se 10 copë në DVP Tirane.
- e) Numri i armëve të shkurtra, kategoria (B1) jo më pak se 2 copë në DVP Tirane.

2.3.5 Operatori ekonomi për të vertetuar se përmbush kapacitetin teknik për ruajtjen e objekteve të rëndësishme të vecante me armë të gjata të kategorisë (B4) dhe me armë të shkurtra (B1) duhet të paraqesë vertetim nga drejtoria e policisë Tiranë jo më parë se gjashtë muajt për të dyja keto kategori

Shënim: Për piken 2.3.4 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar neni 41, pika 4, germa "a", "b" dhe "c", i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë dëshmi për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a. licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b. një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c. fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e licencës/autorizimit dhe vërtetimit është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë kapacitetet teknike dhe profesionale për realizimin me sukses të kontratës.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterëve të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të përmbushë kontratën me sukses.

Gjithashtu numri I punonjësve të sipërcituar është vendosur bazuar në udhëzimin e brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, përcaktohet se numri minimal i punonjësve të shërbimit për një turn duhet të jetë me koeficientin 1.66, pra për një shërbim 24 orësh (3 turne) është 4.98 roje/ për vendroje.

Ne kërkojmë ruajtje sigurie për 11 vendshërbime 24 orësh të cilat në total shkojnë 54.78 roje.

Kërkesa për armë është vendosur për vetë natyrën e objekteve që kërkojmë të ruhen (depo uji, impjanti dhe diga Bovillë, vendburime etj), pra objektet që kërkojnë një siguri më të lartë (në mënyrë të armatosur) janë 9, nga 11 në total.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë 3 automjete dhe 2 motora.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Ne rastet kur mjetet janë në pronësi:

- Certifikat Pronësie,
- Leje Qarkullimi,
- Siguricion (i vlefshëm)
- Kontroll Teknik
- Takse Vjetore.

Ne rastet kur mjetet janë me qera:

- Kontrate Qeraje në formën noteriale e cila të mbulojë gjithë periudhën e shërbimit të kërkuar nga AK.
- Certifikatë Pronësie,
- Leje Qarkullimi,
- Sigurim,(i vlefshëm)
- Kontroll Teknik
- Takse Vjetore.

Shënim: Për pikat 2.3.5 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin në sistemin e prokurimit publik formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/1 gërma c), neni 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 41 pika 4 gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Gjithashtu në bazë të ligjit 75/2014 dhe udhëzimit të brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, për kryerjen me efikasitet të shërbimit, mjetet e shërbimit janë si një domosdoshmëri për ndërhyrje në mënyrë urgjente në rast ngjarje për të ardhur në ndihmë rojes së sigurisë dhe objektit që ai ruan nga grupet e gatshme të shoqërisë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik të prokurimeve Vërtetimin lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tirane jo më parë se viti 2023, kategoria 1.3.B,

konform ligjit nr.75/2014 dhe akteve nenligjore ne fuqi per funksionimin e sherbimit privat te sigurise fizike permes te cilit te provohet qe operatori ekonomik disponon:

f) Jo me pak se 15 punonjes sherbimi, te kategorise 1.3.B.

g) Jo me pak se 3 pergjegjes eskorte.

h) Jo me pak se 10 cope arme te gjata kategoria (B4) ne DVP Tirane.

i) Operatorët ekonomikë të mos kenë marrë mase administrative për periudhen Janar 2023 e ne vazhdim.

j) Operatorët ekonomikë të mos kenë ngjarje per periudhen Janar 2023 e ne vazhdim.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej operatorëve pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetimin e lëshuar nga drejtoria vendore e policisë Tiranë.

Shënim: Për pikat 2.3.6 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/1 gërma c), neni 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 41 pika 4 gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Gjithashtu në bazë të ligjit 75/2014 dhe udhëzimit të brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për funksionimin e sherbimit privat të sigurisë fizike, kërkesat e sipërpërmendura janë të nevojshme për kryerjen e transportit të vlerave monetare. Transporti do të kryhet me mjete të blinduara, të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me punonjës shërbimi të licensuar sipas kësaj kategorie, të armatosur dhe të koordinuar për mbarëvajtjen e gjithë itinerarit nga përgjegjësat e eskortave.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik të prokurimeve certifikatat e punonjesve të sherbimit për jo më pak se 58 punonjës për nënkategorinë 1.3.A dhe 15 punonjës shërbimi për nënkategorinë 1.3.B konform Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, shoqëruar me listen emerore të punonjesve të sherbimit të punësuar në DVP Tirane (te

vlefshme) te nenshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori. Punonjesit e pasqyruar ne listen emerore te nenshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori duhet te figurojne ne listepagesat e sigurimeve shoqerore minimumi 3 muajt e fundit. Në rast bashkimi te operatorve ekonomik lista emerore duhet te paraqitet ne perputhje me perqindjen e marr persiper në kontratën e bashkëpunimit.

Shënim: Persa i perket listepagesave te sigurimeve shoqerore minimumi 3 muajt e fundit operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë vendosur në mbështetje të ligjit nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Per rregullat e prokurimit publik”, Neni 77, pika 4 si dhe në mbështetje të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41 pika 4. Në bazë të udhëzimit të brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, përcaktohet se numri minimal i punonjësve të shërbimit për një turn duhet të jetë me koeficientin 1.66, pra për një shërbim 24 orësh (3 turne) është 4.98 roje për vendroje. Ne kërkojmë ruajtje sigurie për 11 vendshërbime 24 orësh të cilat në total shkojnë 54.78 roje.

2.3.8 Për shoqërimin e vlerave monetare operatori ekonomik duhet të disponojë 8 autoblanda, **niveli i blindimit të jetë jo më pak se BR4.** Per te vertetuar disponimin e ketyre blindave, operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin ne vijim:

Ne rastet kur autoblindat jane ne pronesi:

- Autorizim i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,
- Certifikat Pronesie,
- Leje qarkullimi,
- Kontroll teknik,

- Taksat e mjetit
- Siguracioni i mjetit (e vlefshme)

Ne rastet kur autobлиндat janë me qira:

- Kontrate Qeraje në formën noteriale për gjithë perjudhen e shërbimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Autorizim i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në emër të qiramarresit,
- Certifikatë Pronësie,
- Leje Qarkullimi,
- Kontroll Teknik,
- Taksat e Mjetit
- Siguracioni i Mjetit (e vlefshme)

Shënim: Për pikat 2.3.8 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin në sistemin elektronik të prokurimeve formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/1 gërma c), neni 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 41 pika 4 gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/I.

Gjithashtu në bazë të ligjit 75/2014 dhe udhëzimit të brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, Përcaktohet numri i automjeteve të blinduara në varësi të vlerave monetare që ata transportojnë.

2.3.9 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjesve të siguruar për tre muajt e fundit (Gusht 2025, Shtator 2025, Tetor 2025) , shoqëruar me listat e sigurimeve shoqërore për periudhën e kërkuar më lart.

Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht 75 punonjes të siguruar në muajt nga të cilët 60 punonjës shërbimi si dhe Drejtuesit Teknikë dhe Administratorin.

Shënim: Për pikat 2.3.9 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/1 gërma c), neni 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 41 pika 4, gërma b) dhe c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Ky kriter gjithashtu është vendosur bazuar në numrin e rojeve që kërkon një objekt për tu ruajtur fizikisht bazuar në koeficientin (1.66 roje për turn).

2.3.10 Operatori Ekonomik ofertues në zbatim të ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" neni 22 i tij, duhet të ketë në stafin teknik 1 (një) inxhinier elektronik/teknologji informacioni/, inxhinieri telekomunikacioni/informatikë ekonomike/informatike/inxhinieri informatike.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqetë dokumentacionin (diplomë, kontrata e punës).

Prania e inxhinierit është e nevojshme për mirëmbajtjen e sistemit elektronik të sallës së kontrollit dhe sistemin e alarmit i cili duhet të figurojë në listat e shoqërisë minimumi 3

muajt e fundit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej operatorëve ekonomikë shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar më lart.

Shënim: Për pikat 2.3.10 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Inxhinier elektronik/teknologji informacioni/, inxhinieri telekomunikacioni/informatikë ekonomike/informatike/inxhinieri informatike, është i domosdoshëm si një specialist që ka njohuri të thelluara në sistemet kompjuterike të sallës operative, në sistemin e kamerave që monitorojnë, në sistemet GPS të automjeteve dhe në cdo rast ndërhyjnë dhe ofron asistencën e tij teknike në problematika të ndryshme që mund të hasin gjat zbatimin të kontratës.

2.3.11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë preventivin dhe analizën e kostos së shërbimit për një roje në muaj në perputhje me parashikimet e Shtojcës 1, duke u mbështetur në legjislationin në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës për Punonjesit e Shërbimit dhe shërbimin.

Mosparaqitja e këtij preventivi, analizës së cmimit dhe ofertimi nën kosto minimale ligjore përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik "i ndryshuar, si dhe të respektojnë rigorozisht udhëzimet e APP për operatorët ekonomike për rastin e bashkimit të operatoreve në procedurat elektronike të prokurimit .

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e Prokurimit